



| | |
|---|---|
| REPUBLIKA E KOŠOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. Dep. 2-D/DPK | Nr Prot. Br.Prot. 01-1355/14 Prot No. |
| Nr. I faq. Broj stranica 02 Nr. pages | Data Datum 16-04-2014 Date |
| PRISHTINË | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.04.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-213/14, për z. Menduh Mulhaxha dhe znj. Aferdita Mulhaxha – gjykatës në Gjykatën Themelore të Pejës, për arsye se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-213/14, për z. Menduh Mulhaxha dhe znj. Aferdita Mulhaxha – gjykatës në Gjykatën Themelore të Pejës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit (më tutje Agjencia), pas pranimit të informatës për dyshimin e ekzistimit të konfliktit të interesit, ka filluar trajtimin e këtij rasti duke vërtetuar faktet dhe provat në dispozicion.

Në këtë rast, zyrtarët në fjalë janë trajtuar për dyshimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tyre si gjykatës në Gjykatën Themelore të Pejës për shkak të lidhjes së tyre familjare (burrë e grua).

Agjencia, si institucion i pavarur, që ndër të tjera bën mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara ligjore (neni 5 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit), pas trajtimit të

rastit, konstaton se ushtrimi i funksioneve të gjykatësve nga bashkëshortët gjykatës në të njëjtën gjykatë, në bazë të ligjeve në fuqi, nuk është i ndaluar.

Mirëpo, në bazë të bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, gjykatësit në fjalë janë të obliguar që të bëjnë deklarinë “rast për rast” të interesave private, në rastet kur duhet të shmangen nga ndonjë vendimmarrje e veçantë për shkak të lidhjes së tyre familjare.

Kjo është e rregulluar me nenin 13 (paragrafi 1) të këtij ligji, ku thuhet se: “Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarinë paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit”.

Rastet e deklarinë të konfliktit rast për rast të interesave private janë të parapara në paragrafin 2 të këtij neni, në të cilin thuhet: “Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa me shpejt që të jetë e mundur”.

Ndërsa, mënyra e deklarinë është me shkrim, siç parashihet në paragrafin 3 të këtij neni.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

